



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Medplus" Sh.P.K. të datës 19.09.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 07.09.2023 për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe barna dhe material shpenzues mjekësor për nevojat e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-9366-1-1-1, Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit merr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Medplus" Sh.P.K. e datës 19.09.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 07.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe barna dhe material shpenzues mjekësor për nevojat e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-9366-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Medplus" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Medplus" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 19.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 07.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe barna dhe material shpenzues mjekësor për nevojat e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-9366-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I):** *Ne kemi kërkuar që të largohet kërkesa prej 5 viteve përvojë pune për teknikun e farmacisë, sepse e njëjta kërkesë nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit ose të largohet në tërësi kërkesa për teknik të farmacisë, pasi që po kërkohet farmacisti dhe në këtë rast kemi të bëjmë me furnizime e jo shërbime dhe nuk ka nevojë të jetë kjo kërkesë e dosjes së tenderit. Arsyetimi se tekniku merret me përgatitjen e produkteve dhe kërkesa për përvojë të punës nuk janë në harmoni njëra me tjetrën, e po ashtu përgatitja e produkteve nuk do të thotë se duhet të bëhet nga një teknik i farmacisë me përvojë punë aq të madhe, madje nuk nevojitet fare prezenca e teknikut kur kemi parasysh faktin se kërkesë e dosjes së tenderit është edhe farmacisti. Andaj kërkojmë që të largohet në tërësi kërkesa në lidhje me teknikun e farmacisë ose përvoja e kërkuar për të njëjtin, pasi që siç edhe e kemi cekur në këtë aktivitet të prokurimit kur dihet që në këtë rast kemi të bëjmë me furnizime e jo shërbime është i qartë fakti se nuk ka nevojë të përcaktohet një kërkesë e tillë në dosje të tenderit.*
- **Pretendimi i dytë (II):** *Kërkojmë që të largohet kërkesa për të ofruar mostra vetëm për këto produkte (poz 113,132,168,169,175) sepse po tingëllon tendencioze dhe nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Sipas neve këto pozicione nuk janë më të rëndësishme se pozicionet tjera, prandaj konsiderojmë se kërkesa e tillë është e panevojshme.*
- **Pretendimi i tretë (III):** *Kërkojmë të largohet kërkesa për ISO dhe CE për materialet shpenzuese tek pika 6, sepse për materialet shpenzuese të klasës i kërkohen deklaratat e konformitetit. Produktet që parashihen të furnizohen në këtë tender është e qartë se të njëjtat pa ISO dhe CE nuk mund të importohen dhe realisht janë të panevojshme këto kërkesa, të parapara nga AK andaj kërkojmë të largohen nga dosja e tenderit.*
- **Pretendimi i katërt (IX):** *Në lidhje me sqarimin tonë sa i përket paisjes së kërkuar një Kamion 7.5T me rampe, autoriteti kontraktues ka dhënë përgjigjen si në vijim: Pajisjet e transportit janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Kamioni është mjet esencial për transportimin sidomos të infuzioneve (nacl, glucose, ringer) dhe ne e kemi paraparë që duhet në çdo qendër të liferohen dhe është shumë e vështirë për stafin teknik të QKMF-së të transportohet me dorë. Kjo kërkesë është mjaft bashkohore dhe e nevojshme të transportohen me transpaleta nga kamioni që ka liftin lëvizës (rampe). Ky sqarim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm për faktin se ne në sqarimin që e kemi bërë e kemi cekur qartë se kërkesa është kufizuese dhe diskriminuese/përkatësisht favorizuese, prandaj kërkojmë që të largohet kërkesa për Kamion 7.5 ton, dhe të lejohet një minimum real dhe i arsyeshëm i kamionit apo pajisjes për bartje. Autoriteti kontraktues përveç faktit që nuk e ka larguar kërkesën në lidhje me kamionin e njëjta nuk e ka lejuar as minimumin real dhe të arsyeshëm të kamionit/paisjes për bartje. Kërkesa e autoritetit kontraktues është kërkesë diskriminuese, dhe njëkohësisht kërkesë e cila favorizon një OE të caktuar i cili e posedon paisjen e tillë ashtu siç e ka kërkuar autoriteti kontraktues.*
- **Pretendimi i pestë (V):** *Në lidhje me kërkesën e dosjes së tenderit Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme për furnizime në vlerë minimale në 3 (tri - 2020- 2021-2022) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë) për 300.000,00 €, ne kemi kërkuar nga AK-ja sqarim se pranohen raportet e pranimit të mallit për kontratat ne vazhdim e sipër por që dëshimohen furnizimet me fletëpranime të mallit dhe transaksione bankare. Autoriteti kontraktues nuk e ka lejuar një gjë të tillë, mirëpo vetëm e ka cekur që duhet ti referohemi kërkesës së dosjes së tenderit. Ne edhe një herë kërkojmë që të ndryshohet kërkesa duke u lejuar të prezantohen edhe raportet e*

pranimet të mallit për kontratat në realizim e sipër, të cilat furnizime dëshmojnë me fletëpranime të mallit dhe transaksione bankare, me qëllim që të hapet konkurrenca dhe mos të favorizohen OE të caktuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore.

Rrjedhimisht me datë 22.09.2023 njësia kërkuese ka dërguar përgjigjen si në vijim:
Përgjigjeja nr. 1:

Kërkesa që tekniku i farmacisë të ketë përvojë pune është kërkesë ligjore pasi që depo farmaceutike duhet për tu liqencuar nga AKPPM-ja si qarkullues të ketë Farmacistin dhe Teknikun kurse për përvojën e punës është e drejtë e AK-së të kërkojë pasi që tekniku merret me përgatitjen e produkteve dhe janë produkte të ndjshme dhe duhet të

kemi liferimin sipas PSO nga depo farmaceutike në depon e QKMF-së dhe QMU-së pra sipas rregullave të parapara.

Përgjigjeja nr. 2:

Kërkesa për ofrimin e mostrave është kërkesë për tu verifikuar saktësia e produktit dhe kualiteti për këto pozicione dhe kjo kërkesë është e drejtë e AK-së të bëjë kërkesën për këto mostra pasi për shkak se ne nuk kemi dashur të vështirësojm ofertimin duke mundur të kërkojm të gjitha produktet të ofrohen mostrat dhe gjatë liferimit të kemi

furnizim të njëjtë dhe kualitativ pas që kemi të bëjmë me një Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare mjaft të madhe si Regjion.

Përgjigjeja nr. 3:

Ju në ofertë duhet të prezentoni ISO dhe CE (për produktet që nuk kanë CE mund të paraqitni certifikatë të konformitetit sipas rregullave të AKPPM-së dhe BE-së për verifikimin e cilësis së produkteve me Certifikata).

Përgjigjeja nr. 4:

ISO 9001 është për menagjimin e kompanisë kurse ISO 13485 është për menagjimin e produkteve mjekësore nga distributorët apo prodhuesit,

Përgjigjeja nr. 5:

Nuk kemi të bëjmë me favorizim! Kamioni është mjet esencjal për transportimin sidomos të infuzioneve (nacl,glucose,ringer) dhe ne e kemi paraparë që duhet në cdo qendër të liferohen dhe është shumë e vështirë për stafin teknik të QKMF-së të transportohet me dorë.Kjo kërkesë është mjaft bashkohore dhe e nevojshme të transportohen me transpaleta nga kamioni që ka liftin lëvizës (rampe).

Përgjigjeja nr. 6:

Referojuni dosjes së tenderit, 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme për furnizime në vlerë minimale në 3 (tri - 2020- 2021-2022) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë) për 300.000,00 €".

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 22.09.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.